



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Avokatura Istrefi” Sh.P.K. të datës 22.02.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të datës 01.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimet e përfaqësimit, avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit” me nr. të prokurimit 616-24-599-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Avokatura Istrefi” Sh.P.K. e datës 22.02.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të datës 01.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimet e përfaqësimit, avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit” me nr. të prokurimit 616-24-599-2-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik “Avokatura Istrefi” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. **Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.**

Arsyetim

Operatori ekonomik “Avokatura Istrefi” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 22.02.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të datës 01.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimet e përfaqësimit, avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit” me nr. të prokurimit 616-24-599-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi 1 - Parashtruesi kërkon që të ndryshohet/plotësohet kërkesa e dosjes së tenderit sipas të cilës kërkohet që tenderuesi të jetë shoqëri e avokatëve e regjistruar me mbi 7 vite dhe të ketë të punësuar së paku 5 avokat të licensuar.

Pretendimi 2 - Parashtruesi kërkon që të ndryshohet/plotësohet kërkesa e dosjes së tenderit pozicioni 5 (5.1 dhe 5.2).

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, duhet cekur se AK ka publikuar formularin për korrigjimin e gabimeve sipas të cilët tanimë janë ndryshuar/plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit të cilave ju referohen pretendimi i parë dhe pretendimi i dytë ankimor.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se pretendimet ankimore i referohen kërkesave në dosjen e tenderit të cilat tanimë janë korrigjuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 27.02.2024

Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.